

YOU COULD BE A LIFE SAVER

**Ligji për dhurimin e organeve
ndryshon në pranverën e vitit 2023.**

Duke filluar nga pranvera e vitit 2023, sistemi i dhurimit të organeve do të shndërrohet në një sistem me zgjedhje. “Ligji Daíthí” do të thotë se në rast se dhurimi i organeve bëhet i mundur pas vdekjes suaj, përveç nëse zgjidhni të mos përfshiheni, ose i përkisni një grupi të përjashtuar, ju do të konsideroheni si dhurues i mundshëm i organeve.



Zbuloni më shumë në adresën:
organdonationni.info



Dhurimi i organeve është një vendim personal dhe ju do të keni ende një zgjedhje nëse dëshironi të dhuroni ose jo.

Në rast se nuk dëshironi të bëheni dhurues i organeve, ju duhet të zgjidhni të mos përfshiheni në Regjistrin e Dhuruesve të Organeve të NHS [Shërbimi Kombëtar i Shëndetësisë]. Ju mund ta bëni këtë në çdo kohë deri dhe pas ndryshimit të ligjit në pranverën e vitit 2023.

Deri atëherë, në rast se dëshironi të konsideroheni si një dhurues pas vdekjes suaj, ju lutemi vazhdoni të regjistroni vendimin tuaj në Regjistrin e Dhuruesve të Organeve të NHS [Shërbimi Kombëtar i Shëndetësisë].

Çfarëdo që të vendosni, ju lutemi mos harroni të flisni me të afërmit tuaj në mënyrë që t'i ndihmoni ata të mbështesin vendimin tuaj në një periudhë të vështirë.

Për më shumë informacion mbi ndryshimin e ligjit ose për të regjistruar një vendim për të mos u përfshirë, ju lutemi vizitoni adresën organdonationni.info

***Grupet e përjashtuara përfshijnë:**

- Personat nën moshën 18 vjeç
- Personat të cilëve u mungon aftësia mendore për të kuptuar ligjin e ri
- Vizitorët në Irlandën e Veriut
- Banorët e përkohshëm

